<p>cytjen në aktivitete seksuale me fëmijën, duke keqpërdorur pozitën e besimit ose autoritetin e prindit, kujdestarit ose ofruesit të kujdesit;</p> <p>1.37.3. aktivitet seksual i cili nënkupton marrëdhënie seksuale dhe çdo formë tjetër e kryer nga, me, dhe para fëmijës, ku prania ose pjesëmarrja e fëmijës është për qëllim të kënaqësisë seksuale të personit tjetër.</p> <p>1.38. Institucionet – kur konteksti nuk e përcakton ndryshe, nënkupton të gjitha institucionet publike, të nivelit qendror dhe lokal si dhe personat tjerë juridike privat në Republikën e Kosovës, që kanë përgjegjësinë për mbrojtjen e fëmijës në kuptimet e përcaktuara në këtë Ligj dhe legjislacionin në fuqi;</p> <p>1.39. Konventë - nënkupton Konventën për të drejtat e fëmijës;</p> <p>1.40. Këshilli - nënkupton Këshilli Ndërmintor për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës;</p> <p>1.41. Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) – nënkupton Zyrën për</p>	<p>commitment, or encouragement in sexual activities with the child, by misusing the position of the trust or authority of a parent, guardian or health care providers;</p> <p>1.37.3. Sexual activity which means sexual relationship and any other form carried out by, with and in front of the child, where presence or participation of the child is for the purpose of sexual satisfaction of another person.</p> <p>1.38. Institutions - where the context does not determine otherwise, means all public institutions, central and local level and other private legal persons in the Republic of Kosovo, those who are responsible for the protection of the child in meanings stipulated in this law and in applicable legislation;</p> <p>1.39. The Convention - means the Convention on the rights of the child;</p> <p>1.40. Council - refers to Inter-ministerial Council for the Protection of Children Rights;</p> <p>1.41. Office of Good Governance (OGG) - means the Office for Good</p>	<p>ili potpirivanje seksualnih aktivnosti sa detetom, zlopotrebljavajući položaj roditeljskog autoriteta ili poverenja staratelja ili pružaoca staranja;</p> <p>1.37.3. Seksualnu aktivnost koja podrazumeva seksualni odnos i svaku drugu seksualnu formu izvršenu sa detetom ili u prisustvu deteta, čije prisustvo služi svrsi seksualnog zadovoljavanja druge osobe.</p> <p>1.38. Institucije – ako nije drugačije definirano u kontekstu, podrazumeva sve centralne i lokalne javne ustanove kao i privatne subjekte u Republici Kosova koje su odgovorne za zaštitu deteta u smislu ovog i drugih važećih zakona;</p> <p>1.39. Konvencija - podrazumeva Konvenciju o pravima deteta;</p> <p>1.40. Savet - podrazumeva Međuministarski savet za zaštitu prava deteta;</p> <p>1.41. Kancelarija dobrog upravljanja (KDU) – podrazumeva Kancelariju</p>
---	---	--

<p>Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.</p> <p>1.42. Person i zhvendosur - nënkupton personin ose grupet e personave të cilët janë detyruar me forcë që të ikin ose të largohen nga shtëpitë e tyre ose vendet e banimit të përhershëm, në veçanti si rezultat ose në mënyrë që të shmangen pasojat e konflikteve të armatosura, situatat e dhunës së përgjithësuar, shkeljet e të drejtave të njeriut apo fatkeqësive natyrore, të cilët nuk kanë kaluar ndonjë kufi shtetëror të njohur ndërkombëtarisht.</p> <p>2. Përcaktimi i të gjithëve si fëmijë, i përdorur në këtë Ligj, zbatohet në mënyrë të barabartë si për femra po ashtu edhe për meshkuj, pavarësisht seksit, gjinisë apo identitetit gjinor.</p> <p>KAPITULLI II – PARIMET E MBROJTJES SË FËMIJËS</p> <p>Neni 4 E drejta për jetë, mbijetesë dhe zhvillim</p> <p>1. Mbrojta e jetës së fëmijës duhet të jetë detyrimi kryesor për çdo person, institucion apo organ tjetër.</p>	<p>Governance within the Office of the Prime Minister.</p> <p>1.42. Displaced person - means a person or group of persons who are forced to leave or depart from their homes or places of permanent dwelling, in particular as a result or in order to avoid consequences of armed conflict, situations of general violence, human rights violations or natural disasters, which have not spread beyond any internationally recognized state border.</p> <p>2. Determination of all as a child used in this law, applies equally for females as well as males, regardless of sex, gender or gender identity.</p> <p>CHAPTER II - CHILD PROTECTION PRINCIPLES</p> <p>Article 4 The right to life, survival and development</p> <p>1. Protection of life of the child should be the main obligation for every person, institution or other body.</p>	<p>dobrog upravljanja u okviru Ureda premijera.</p> <p>1.42. Raseljeno lice – podrazumeva osobu ili grupu lica koja su bila primorana napustiti njihove kuće gde su stalno boravili, naročito usled konflikta, kako bi izbegli posledice oružanih sukoba u situacijama opšteg nasilja, u kojima se krše ljudska prava, ili usled prirodnih nesreća, ali nisu prelazili međunarodno priznatu državnu granicu.</p> <p>2. Definicija svo dece kao dete, korišćena u ovom Zakonu, primenjuje se jednako za decu bilo muškog ili ženskog roda, t.j. bez obzira na pol, rod, ili rodni identitet.</p> <p>POGLAVLJE II - NAČELA ZAŠTITE DETETA</p> <p>Član 4 Pravo na život, egzistenciju i razvoj</p> <p>1. Zaštita života deteta mora biti glavni zadatak svake osobe, institucije ili drugog organa;</p>
---	--	--

<p>2. E drejta e fëmijës për mbijetesë dhe zhvillim, që do të thotë në zhvillimin fizik, mendor, emocional, edukativ, social si dhe mirëqenia e fëmijës, duhet të jenë të mbrojtura në masën maksimale të mundshme nga çdo person, institucion apo organ tjetër.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Interesi më i mirë i fëmijës</p> <p>1. Të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo kujdestari, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës si, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, gjykatat, autoritetet administrative apo nga organet legjislative, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.</p> <p>2. Interesi më i mirë i fëmijës kërkon një përpjekje tërësore për të siguruar integritetin fizik, psikologjik, moral dhe shpirtëror të fëmijës dhe për të promovuar dinjitetin njerëzor të tij ose të saj, duke marrë parasysh karakteristikat individuale dhe gjendjen social të fëmijës.</p> <p>3. Interpretimi i interesit më të mirë të fëmijës duhet të jenë në tërësi në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijë si</p>	<p>2. The right of the child for survival and development, which means in physical, mental, emotional, educative and social development, and welfare of the child must be protected to maximum extent possible by any person, institution or other body.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 The best interest of the child</p> <p>1. All actions and decisions that have to do with the child, taken by parents or guardian, institutions and services for child protection such as professionals for child protection, courts, administrative authorities or legislative bodies, the best interest of the child shall have the dominant considerations.</p> <p>2. The best interests of the child require a comprehensive effort to ensure physical, psychological, moral and spiritual integrity of the child and to promote the human dignity of his or her, taking into account the individual characteristics and social situation of the child.</p> <p>3. Interpretation of the best interest of the child must be fully in line with the Convention on the rights of the child and</p>	<p>2. Pravo deteta na egzistenciju i razvoj, odnosno fizički, mentalni, emocionalni, obrazovni i socijalni razvoj, kao i njegovo blagostanje mora biti zaštićeno u najvećoj mogućoj meri od svakog lica, institucije ili drugog organa.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Najbolji interes deteta</p> <p>1. U svim odlukama i postupcima o detetu koje donose roditelji, staratelji, institucije, službe za zaštitu deteta, profesionalci za zaštitu deteta, pružaoci staranja, sudovi, administrativni ili pravosudni organi, moraju prevladati najbolji interes deteta, odnosno moraju se uvažiti najbolji interes deteta.</p> <p>2. Najbolji interes deteta iziskuje celokupno nastojanje za obezbeđivanje njegovog fizičkog, psihičkog, moralnog i duhovnog integriteta i za promociju njegovog/njenog ljudskog dostojanstva i uvažavanja individualnih osobina i socijalnog stanja deteta.</p> <p>3. Najbolji interes deteta mora biti tumačen potpuno u skladu sa Konvencijom o pravima deteta, i nikakva preuzmirana</p>
---	---	---

<p>dhe asnjë interpretim i supozuar i asaj se çka është në interesin më të mirë të fëmijës nuk mund të justifikojë shkeljen e çfarëdo të drejte të njohur nga Konventa.</p>	<p>no alleged interpretation of what is in the best interest of the child can justify the violation of any right recognized by the Convention.</p>	<p>interpretacija o tome šta je u najboljem interesu deteta ne može opravdati kršenje bilo koje Konvencijom priznato pravo.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 6 Zhvillimi gradual i aftësive</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Gradual development of skills</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Postepeni razvoj sposobnosti</p>
<p>Parimi i zhvillimit gradual të aftësive, duhet të merret parasysh në përputhje me zhvillimin e aftësive të fëmijës dhe t’ju jepet rëndësia e duhur në të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo kujdestari, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, ofruesit e kujdesit, gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislativë.</p>	<p>The principle of gradual development of skills should be taken into consideration in accordance with the development of skills of the child and be granted the importance of appropriate actions and decisions that have to do with the child, taken by parents or guardian, institutions and services for the protection of the child, professionals for child protection, care providers, courts, administrative authorities or legislative bodies.</p>	<p>Načelo postepenog razvoja deteta mora se uzeti u obzir u skladu sa razvojem sposobnosti deteta i tome pridati adekvatan značaj svim odlukama i postupcima koji se odnose na dete, a koje donose roditelji, staratelji, institucije, službe za zaštitu deteta, profesionalci za zaštitu deteta, pružaoci staranja, sudovi, administrativni ili pravosudni organi.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7 Respektimi i pikëpamjes së fëmijës</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 Observance of views of the child</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Uvažavanje mišljenja deteta</p>
<p>1. Në të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijët, të marra nga prindërit apo kujdestari, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, ofruesit e kujdesit gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislativë, kanë për obligim t’i garantojnë fëmijës, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, të drejtën për t’i shprehur lirisht këto</p>	<p>1. In all actions and decisions that have to do with children, taken by parents or guardian, institutions and services for the protection of the child, professionals for child protection, care providers, courts, administrative authorities or legislative bodies, have the obligation to ensure the child who is able to have their own views on the right to freely express these opinions, on any matter that has to do with</p>	<p>1. Sve preduzete aktivnosti i donošene odluke roditelja, staratelja, institucije, službi za zaštitu deteta, profesionalaca za zaštitu deteta, pružaoca staranja, sudova, kao i upravnih autoriteta i pravosudnih organa, koja se tiču njega, detetu sposobnog na svoje mišljenje, moraju zagarantovati pravo na slobodno izražavanje njegovog mišljenja o svakom pitanju koje se odnosi na njega, i oceniti je</p>

<p>pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit në fuqi.</p> <p>2. Kur një vendim apo veprim që ka të bëjë me fëmijën, i cili është i aftë për të gjykuar dhe është i informuar dhe dëgjuar, mendimi i tij merret në konsideratë sipas moshës dhe sipas shkallës së pjekurisë, gjithnjë duke marrë parasysh edhe rrethanat e ofrimit të ndihmës dhe përkrahjes, në rastet kur fëmija nuk mund të shprehet. Fëmijës, i cili nuk është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, ofruesit e kujdesit, gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, kanë për obligim t'i garantojnë fëmijës mbrojtjen e njëjtë, sikur në rastet kur fëmija është në gjendje të shpreh pikëpamjet e tij/saj në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Ndalimi i diskriminimit ndaj fëmijës</p> <p>1. Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë</p>	<p>it, assessing them in accordance with the age and the level of his/her maturity, either directly or through a representative or an appropriate body, in accordance with the rules of procedure of the legislation in force.</p> <p>2. When a decision or action that has to do with the child who is capable to judge and is informed and has heard, his/her opinion is taken into consideration by age and according to maturity level, always taking into account the circumstances of the provision of assistance and support in cases when a child cannot express him/herself. The children who are not able to have their own views, institutions and services for the protection of the child, professionals for the protection of the child, care providers, courts, administrative authorities or legislative bodies, have the obligation to ensure child protection in the same way as in cases where the child is able to express his/her views in accordance with the rules of procedure of the applicable legislation.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Prohibition of discrimination against children</p> <p>1. Direct or indirect discrimination against</p>	<p>u skladu sa njegovim godinama starosti i stepenom njegove zrelosti, bilo neposredno ili preko njegovog zakonskog zastupnika, ili preko podobnog organa, u skladu sa proceduralnim pravilima važećih zakona.</p> <p>2. Kada se jedna odluka ili postupak tiče deteta sposobnog za rasuđivanje, ono mora biti informisano i mora se uvažavati njegovo mišljenje u skladu sa njegovim godinama starosti i stepenom njegove zrelosti, imajući u obzir uvek okolnosti pružanja pomoći i podrške u slučaju kada se dete ne može izražavati. Institucije, službe za zaštitu deteta, profesionalci za zaštitu deteta, pružaoci staranja, sudovi, upravni autoriteti i pravosudni organi dužni su da, u skladu sa proceduralnim pravilima važećih zakona, detetu koje nije sposobno dati svoje mišljenje, garantovati mu istu zaštitu kao da je sposobno izražavati njegovo/njeno mišljenje.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Zabrana diskriminacije prema detetu</p> <p>1. Zabranjuje se neposredna ili posredna</p>
--	---	--

<p>apo i tërthortë ndaj fëmijës, duke përfshirë trajtimin më pak të favorshëm të fëmijës për shkak të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike, veprimtarive, opinionëve të shprehura ose bindjeve të prindërve apo kujdestarit të tyre, ose të anëtarëve të familjes së tij ose ndonjë bazë tjetër me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë siç është përcaktuar në Ligjin përkatës për mbrojtjen nga diskriminimi, apo ndonjë bazë të përcaktuar në Konventën për të Drejtat e Fëmijës apo marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare në fuqi, ose ndonjë bazë tjetër të përcaktuar me ligjet në fuqi.</p> <p>2. Të gjitha institucionet, ofruesit e shërbimeve, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës si dhe ofruesit e kujdesit, duhet të marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit.</p>	<p>a child, including dealing with less favourable child because of nationality or connection with any community, national or social origin, race, ethnicity, colour, birth, origin, sex, gender identity, gender, sexual orientation, language, citizenship, religious conviction and faith, political affiliation, political or other affiliations, personal or social status, age, marital status, family status or pregnancy, maternity leave, state property, health status, disability, genetic inheritance, activities, opinions voiced or convictions of the parents or the custodian, or his family members or any other grounds for the purpose of implementation of the principle of equal treatment as defined by the respective Law on protection from discrimination, or any base defined in the Convention on the Rights of the Child or international agreements and instruments in force or any other grounds prescribed by applicable laws.</p> <p>2. All institutions, service providers, child protection professionals and care providers, must take all appropriate measures, in order for the child to be protected from all forms of discrimination.</p>	<p>diskriminacija deteta, uključujući manje povlašćeni tretman zbog njegove nacionalne pripadnosti ili veze sa nekom zajednicom, socijalnog ili nacionalnog porekla, etničke i rasne pripadnosti, boje kože, rođenja, porekla, pola, roda, polnog identiteta, seksualne usmerenosti, jezika, državljanstva, veroispovesti, političke pripadnosti, političkog ili drugog mišljenja, socijalnog ili ličnog statusa, starosti, porodičnog ili bračnog statusa, trudnoće, imovnog stanja, porodiljskog stanja ili zdravstvenog stanja, zbog ograničene sposobnosti, genetskog nasledstva, delatnosti, izražavanja mišljenja ili uverenja roditelja ili staratelja ili članova njegove porodice, ili bilo kojoj drugoj osnovi, u cilju jednakog tretmana deteta u skladu sa Zakonom o zaštiti od diskriminacije ili drugoj osnovi utvrđenoj Konvencijom o pravima deteta ili važećim međunarodnim sporazumima i instrumentima ili drugom osnovom utvrđenom važećim zakonima.</p> <p>2. Sve institucije, službe za zaštitu deteta, profesionalci za zaštitu deteta, pružaoci staranja, moraju preduzeti sve odgovarajuće mere u cilju delotvorne zaštite deteta od svake forme diskriminacije.</p>
---	--	--

<p>3. Prindërit apo kujdestari, anëtarët e familjes, profesionistet për mbrojtjen e fëmijës, ofruesit e kujdesit, të cilët konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj fëmijës, mund të iniciojnë procedura dhe paraqesin fakte para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, në përputhje me dispozitat e Ligjit përkatës për mbrojtje nga diskriminimi.</p> <p>4. Shkeljet e dispozitave të këtij Ligji, në rastet kur përbëjnë vepër penale ose kundërvajtje, dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe Ligjit përkatës për kundërvajtje.</p>	<p>3. Parents or guardian, family members, professionals for child protection, care providers who consider that the principle of equal treatment has not been applied to the child, may initiate the procedure and submit facts before a court or other competent authority in accordance with the provisions of the respective Law on protection from discrimination.</p> <p>4. Violations of the provisions of this Law, in cases when they constitute a criminal or minor offense, shall be convicted under the provisions of the Criminal Code of the Republic of Kosovo and the relevant law on minor offence.</p>	<p>3. Roditelji ili staratelj deteta, članovi njegove porodice, profesionalci za zaštitu deteta, i pružaoci staranja, ako smatraju da se nije ispoštovao načelo jednakog tretmana prema detetu, mogu pokrenuti postupak i prezentirati činjenice pred organom uprave ili pred nadležnim sudom, u skladu sa odredbama Zakona o zaštiti od diskriminacije.</p> <p>4. Kršenje odredaba ovog Zakona u slučaju krivičnog delo ili prekršaja, kazniće se u skladu sa Krivičnom zakoniku Republike Kosova ili Zakonom o prekršajima.</p>
<p>KAPITULLI III PËRGJEGJËSITË PËR MBROJTJEN E FËMIJËS</p>	<p>CHAPTER III RESPONSIBILITIES FOR CHILD PROTECTION</p>	<p>POGLAVLJE III - ODGOVORNOSTI ZA ZAŠTITU DETETA</p>
<p>Neni 9 Përgjegjësia individuale</p>	<p>Article 9 Individual responsibility</p>	<p>Član 9 Individualna odgovornost</p>
<p>1. Çdo person mban përgjegjësi në bazë të dispozitave të këtij Ligji, kur, me veprimet ose mosveprimet e tij, ka bërë shkeljen e këtij Ligji.</p> <p>2. Përgjegjësia individuale nuk e përjashton përgjegjësinë e institucioneve shtetërore ose të personit juridik privat.</p>	<p>1. Every person bears responsibility pursuant to the provisions of the present Law when, by his actions or inactions, has violated this Law.</p> <p>2. Individual responsibility does not exclude the responsibility of state institutions or private legal person.</p>	<p>1. Svaka osoba je, prema odredbama ovog Zakona, odgovorna ako je činjenjem ili nečinjenjem kršio ovaj Zakon.</p> <p>2. Individualna odgovornost ne izuzima institucionalnu, državnu odgovornost ili odgovornost pravnog i privatnog lica.</p>

<p align="center">Neni 10 Përgjegjësia prindërore për mbrojtjen e fëmijës</p>	<p align="center">Article 10 Parental responsibility for child protection</p>	<p align="center">Član 10 Roditeljska odgovornost za zaštitu deteta</p>
<p>1. Përgjegjësia për jetën, sigurinë, mbrojtjen, kujdesin, mirëqenien, zhvillimin dhe edukimin e fëmijës i përket, në radhë të parë, prindit/ërve të fëmijës apo kujdestarit të tij/saj.</p> <p>2. Në ushtrimin e kësaj përgjegjësie prindi/ët ose kujdestari duhet të:</p> <p>2.1. respektojnë dinjitetin, nderin dhe personalitetin e fëmijës;</p> <p>2.2. ofrojnë këshilla dhe udhëzime të mira si dhe ndihmën për fëmijën në përputhje me zhvillimin e tij dhe ta përgatitin atë për një jetë të pavarur dhe të përgjegjshme në shoqëri;</p> <p>2.3. marrin parasysh qëndrimin e fëmijës dhe dëshirat e tij në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tij;</p> <p>2.4. respektojnë dhe promovojnë të drejtën e fëmijës për shëndet, arsim dhe edukim, mirëqenie dhe pjesëmarrje;</p> <p>2.5. sigurojnë që në mungesë të përkohshme të prindit apo kujdestarit,</p>	<p>1. Responsibility for life, safety, protection, development, well-being, care and education of the child, first of all parents of the child or his/her custodian.</p> <p>2. In carrying out this responsibility, parent and the custodian shall:</p> <p>2.1. respect the dignity, and honour the personality of the child;</p> <p>2.2. provide advice and guidance practices as well as assistance for the child in accordance with his/her development and to prepare him/her for an independent life and to be accountable in society;</p> <p>2.3. take into account the position of the child and his/her wishes in accordance with his/her age and maturity;.</p> <p>2.4. respect and promote the rights of the child for health, education, social welfare and participation;</p> <p>2.5. ensure that in temporary absence of parent or custodian, the child has</p>	<p>1. Odgovornost za život, sigurnost, zaštitu, staranje, blagostanje, razvoj i edukaciju deteta spada, pre svega, na roditelje deteta ili njegov/njen staratelj.</p> <p>2. U izvršenju ove odgovornosti roditelj i staratelj moraju:</p> <p>2.1. ispoštovati čast, dostojanstvo i ličnost deteta;</p> <p>2.2. pružati detetu dobre savete, uputstva, i pomoć u skladu sa njegovim razvojem, te pripremati ga za jedan samostalan i odgovoran život u društvu;</p> <p>2.3. uzimati u obzir stav deteta i njegove želje u skladu sa njegovim godinama starosti i njegovom zrelošću;</p> <p>2.4. poštovati i promovisati pravo deteta na zdravlje, vaspitanje, obrazovanje, blagostanje i učešće;</p> <p>2.5. da u slučaju privremenog odsustva roditelja ili staratelja, obezbediti detetu</p>

<p>fëmija duhet të ketë kujdesin adekuat nga personi i caktuar, nga prindi, kujdestari apo organi kompetent.</p> <p>3. Prindërit ose kujdestari kanë të drejtë të marrin mbështetje nga institucionet për të përmbushur përgjegjësitë e përcaktuara në këtë nen. Institucionet duhet të respektojnë përgjegjësinë kryesore të prindërve ose kujdestarëve për edukimin e fëmijës dhe marrëdhëniet midis fëmijës dhe prindërve ose kujdestarit të tij ligjor, ndërsa në të njëjtën kohë duke respektuar dhe duke marrë parasysh zhvillimin gradual të aftësive të fëmijës.</p> <p>4. Institucionet ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që prindërit ose kujdestari, që nuk kanë mundësi të kryerjes së përgjegjësive të tyre, të marrin ndihmën e duhur për të përmbushur përgjegjësitë dhe sigurojnë infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme në këtë drejtim.</p> <p>5. Institucionet kanë përgjegjësinë për të siguruar se fëmijës i është ofruar kujdesi dhe mbrojtja e nevojshme për mirëqenien e tij dhe janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur fëmijët.</p>	<p>adequate care by the person designated by the parent or guardian.</p> <p>3. Parents or guardians shall be entitled to support from institutions to fulfil the responsibilities specified in this article. Institutions must respect the primary responsibility of the parents or custodians for education of the child and the relationship between the child and the parents or legal guardian, while at the same time respecting and taking into account the gradual development of skills of the child.</p> <p>4. Institutions should undertake all necessary measures to ensure that the parent or guardian who are unable to perform their responsibilities, to undertake the necessary support to meet the responsibilities and should provide the necessary infrastructure and services in this direction.</p> <p>5. Institutions have the responsibility to ensure that the child has been provided necessary care and protection for his/her welfare and are obliged to take all necessary measures to protect children.</p>	<p>adekvatno staranje od osobe koju će odrediti roditelj ili staratelj.</p> <p>3. Roditelji ili staratelj deteta imaju pravo na institucionalnu pomoć u ispunjavanju njihovih odgovornosti iz ovog člana. Institucije moraju ispoštovati glavne odgovornosti roditelja ili staratelja deteta za njegovu edukaciju i odnose između deteta i roditelja, ili njegovog zakonskog staratelja i istovremeno imati u obzir i uvažavati postepeni razvoj sposobnosti deteta.</p> <p>4. Institucije moraju preduzeti sve potrebne mere za obezbeđivanje pomoći roditeljima ili staratelju deteta ako oni nisu u stanju da ispune njihove odgovornosti prema detetu, i obezbediti im potrebnu infrastrukturu i usluge u tom pravcu.</p> <p>5. Institucije su odgovorne za obezbeđivanje adekvatne zaštite, starateljstva i blagostanja detetu i da se uvere da je detetu pružena adekvatna zaštita i blagostanje, kao i preduzeti sve potrebne mere za njegovu zaštitu.</p>
---	--	---

<p>6. Kur prindërit ose kujdestari nuk janë në gjendje të përmbushin përgjegjësitë e tyre ndaj fëmijës, pavarësisht mbështetjes së dhënë ndaj tyre, institucionet kanë përgjegjësi të ndërhyjnë dhe të garantojë sigurinë e fëmijës.</p>	<p>6. When the parents or guardians are not able to fulfil their responsibilities toward the child, despite the support provided to them, institutions have a responsibility to intervene and to ensure the safety of the child.</p>	<p>6. Kada roditelji deteta ili njegov staratelj i pored institucionalne pomoći nisu u stanju ispuniti njihove odgovornosti prema detetu, onda su institucije dužne intervenisati i obezbediti detetu sigurnost.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Roli i institucioneve të Republikës së Kosovës</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Role of the institutions of the Republic of Kosovo</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Odgovornosti institucija Republike Kosova</p>
<p>1. Institucionet për mbrojtjen e fëmijës janë të obliguara të zhvillojnë dhe zbatojnë programet sociale që ofrojnë mbështetje për fëmijën dhe ata që kujdesen për fëmijën, me qëllim që të parandalohet rreziku për jetën, dhunën, lenjën pas dore, abuzimin dhe shfrytëzimin.</p>	<p>1. Child protection institutions are obliged to develop and implement social programs that provide support for the child and the ones who take care of the child, in order to prevent risk to the lives or violence, negligence, abuse and exploitation.</p>	<p>1. Institucije za zaštitu deteta dužne su razviti i primeniti socijalne programe koji pružaju podršku “detetu i onima koji se o njemu staraju”, u cilju prevencije opasnosti po njegov život, nasilja, njegovog zapostavljanja, zloupotrebe i njegovog iskorišćavanja.</p>
<p>2. Institucionet marrin të gjitha masat legislative, administrative, shoqërore, sociale, arsimore dhe edukuese për parandalimin, raportimin dhe sigurimin e mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijës, duke pasur parasysh edhe të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, ose kujdestarit.</p>	<p>2. Institutions take all legislative, administrative, society, social and educational measures for prevention, reporting and ensuring the protection and welfare of the child, taking into account the rights and duties of his parents or guardians.</p>	<p>2. Institucije preduzimaju sve zakonske, administrativne, društvene, socijalne i vaspitno-obrazovne mere sprečavanja i obezbeđivanja zaštite i blagostanja deteta, imajući u vidu i prava i obaveze njegovih roditelja ili staratelja.</p>
<p>3. Të gjitha institucionet dhe shërbimet që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijës, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit, duhet të veprojnë në përputhje me parimet dhe dispozitat e këtij</p>	<p>3. All institutions and services responsible for the care and child protection during the exercise of their duties and when drafting policies and legislation, must act in accordance with the principles and provisions of this Law and shall be</p>	<p>3. Sve institucije, službe i pružaoci staranja odgovorni za staranje i zaštitu dece u toku obavljanja njihovih zadataka, izrade politika i zakona, moraju postupiti u skladu sa odredbama i načelima ovog zakona, i odgovorne su za obezbeđivanje</p>

<p>Ligji, si dhe janë përgjegjëse për sigurimin e numrit dhe personelin e aftë për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë Ligj.</p>	<p>responsible for ensuring the number and staff able to carry out duties and responsibilities defined in this Law.</p>	<p>odgovarajućeg broja osoblja, sposobnog za obavljanje ovim zakonom predviđenih zadataka i odgovornosti.</p>
<p>4. Qeveria, përmes ministrive dhe njërive përkatëse, është përgjegjëse që të sigurojë që familjet të kenë qasje ndaj formave të ndryshme të mbështetjes për mbrojtjen e fëmijës si dhe informon lidhur me të gjitha masat dhe programet e mbështetjes.</p>	<p>4. Government, through the ministries and relevant units, is responsible to ensure that families have access to different forms of support for child protection and informs related to all measures concerning the support programs.</p>	<p>4. Vlada preko njenih ministarstva i dotičnih odeljenja odgovorna je da porodicama obezbedi pristup raznim formama podrške i zaštite za njihovu decu i informisati ih o svim pomoćnim merama i programima podrške.</p>
<p>5. Kur familja e vendos fëmijën në situatë rreziku për t'u lënë pas dore, abuzuar, keqtrajtuar ose shfrytëzuar, ose e ekspozon ndaj akteve të shfrytëzimit dhe abuzimit, institucionet përkatëse kanë përgjegjësinë për të mbrojtur fëmijën dhe të sigurojnë kujdesin e përshtatshëm alternativ në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>5. When the family puts the child in jeopardy situation for neglecting, abuse, to be abused or exploited or to be exposed to acts of sexual exploitation and abuse, relevant institutions have the responsibility to protect the child and provide the appropriate alternative care in accordance with the legislation in force.</p>	<p>5. Kada porodica svoje dete izloži opasnosti zloupotrebe, zlostavljanja ili iskorišćavanja, ili ga izlaže iskorišćavanju i zloupotrebi, onda su nadležne institucije dužne i odgovorne da dete štite i obezbeđuju mu alternativno staranje, u skladu sa važećim zakonskim propisima.</p>
<p>6. Ministrinë përkatëse, në përputhje me fushëveprimin dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, janë përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën e mbrojtjes së fëmijës si dhe sigurojnë zbatimin e tyre nga ana e institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal si dhe organizatave të tjera që ofrojnë mbrojtje për fëmijët, në pajtim me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>6. Respective ministries, in accordance with the scope and responsibilities defined by legislation in force, are responsible for development of policies in the field of child protection and ensure their implementation by the responsible institutions at the central and local level and other organisations that provide protection for children, in accordance with the legislation in force.</p>	<p>6. Dotična ministarstva u skladu sa njihovim odgovornostima i u okviru njihovog delokruga utvrđen važećim zakonima, odgovorna su za izradu politika u oblasti zaštite deteta i obezbediti njihovu provedbu od strane institucija lokalnog i centralnog nivoa, kao i drugih organizacija koje pružaju zaštitu za decu, u skladu sa važećim zakonima.</p>
<p>7. Ministrinë përkatëse bashkëpunojnë me</p>	<p>7. The relevant ministries cooperate with</p>	<p>7. Dotična ministarstva sarađuju sa</p>

<p>komunat, me njësitë përkatëse komunale, rrethet akademike, ministritë tjera dhe me palët e interesuara për hartimin e politikave dhe legjislacionit për ruajtjen e nivelit dhe përparimin e mbrojtjes së fëmijës.</p> <p>8. Shteti ka përgjegjësi për marrjen e masave për mbrojtjen e fëmijës nga lënia pas dore, abuzimi, abuzimi seksual, keqtrajtimi, format e shfrytëzimit ekonomik dhe forma të tjera shfrytëzimi nga prindërit, familjarë të tjerë ose kujdestarët.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Këshilli Ndërmintor për Mbrojtjen e Fëmijës</p> <p>1. Qeveria themelon Këshillin Ndërmintor për Mbrojtjen e Fëmijës (Në tekstin e mëtejshëm: Këshilli).</p> <p>2. Këshilli siguron zbatimin e politikave, programeve dhe proceseve për mbrojtjen e fëmijës si dhe për të lehtësuar realizimin e të drejtave të fëmijës, ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Këshilli ka këto përgjegjësi:</p>	<p>municipalities, with relevant municipal units, academia, other ministries and other stakeholders for formulation of policies and legislation for custody and protection of the child.</p> <p>8. The state is responsible for taking measures for the protection of children from neglecting, abuse, sexual abuse, maltreatment, forms of economic exploitation and other forms of exploitation from other members of the family, parents or guardians.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Inter-Ministerial Council for Child Protection</p> <p>1. The Government shall establish an Inter-Ministerial Council for child protection (in further text: Council).</p> <p>2. The Council shall ensure the implementation of policies, programs and processes for child protection and to facilitate the implementation of children rights, between the institutions of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. Council has the following duties and responsibilities:</p>	<p>opštinama i odgovarajućim opštinskim jedinicama, te akademskim krugovima, drugim ministarstvima i drugim zainteresovanim stranama na izradi politika i zakona o čuvanje nivoa i daljeg napretka zaštite deteta.</p> <p>8. Državna je dužna preduzeti mere zaštite deteta od zapostavljanja, zloupotrebe i seksualnog iskorišćavanja, kao i mere protiv zlostavljanja i drugih oblika ekonomskog iskorišćavanja i eksploatacije od strane roditelja, njihovih članova porodice ili njihovih staratelja.</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Međuministarski savet za zaštitu prava deteta</p> <p>1. Vlada osniva Međuministarski savet za zaštitu prava deteta (u daljem tekstu: „Savet“).</p> <p>2. Savet je odgovoran za nadgledanje i primenu politika, programa i procesa zaštite prava deteta i za olakšanje realizacije prava deteta između institucija Republike Kosova.</p> <p>3. Komitet ima sledeće odgovornosti:</p>
--	--	--

<p>3.1. koordinon të gjitha institucionet dhe mekanizmat që merren me mbrojtjen e fëmijës;</p> <p>3.2. debaton për politikat dhe legjislacionin në fushën e mbrojtjes së fëmijës;</p> <p>3.3. themelon grupe punuese të nevojshme për trajtimin e çështjeve të mbrojtjes së fëmijës;</p> <p>3.4. mbështet zhvillimin dhe zbatimin e fushatave të informimit publik dhe të projekteve tjera promovuese për të rritur ndërgjegjësimin mbi standardet e mbrojtjes së fëmijës;</p> <p>3.5. miraton raportin e progresit për zbatimin e Konventës së të drejtave të fëmijës për Komitetin për të drejtat e fëmijës në Gjenevë;</p> <p>3.6. merr vendime dhe jep rekomandime për përmirësimin e mbrojtjes e fëmijës.</p>	<p>3.1. coordinates all institutions and mechanisms that deal with child protection;</p> <p>3.2. debates on policies and legislation in the field of child protection;</p> <p>3.3. appoints working groups needed to deal with the issue of the child protection;</p> <p>3.4. supports the development and implementation of public information campaigns and other promotional projects to raise awareness on child protection standards;</p> <p>3.5. adopts the progress report on the implementation of the Convention on the Rights of the Child for the Committee on the rights of the child in Geneva;</p> <p>3.6. takes decisions and provides recommendations for improving child protection.</p>	<p>3.1 koordinira sve institucije i mehanizme koje se bave zaštitom deteta;</p> <p>3.2. raspravljati o politikama i zakonodavstvu iz oblasti zaštite deteta;</p> <p>3.3. formira potrebne radne grupe za razmatranje pitanja zaštite prava deteta;</p> <p>3.4. podržava razvoj i provedbu javne kampanje informisanja i drugih promocijnih projekata za uzdizanje svesti o standardima zaštite prava deteta;</p> <p>3.5. usvaja izveštaj o napretku provedbe Konvencije o pravima deteta za Komitet o pravima deteta u Ženevi;</p> <p>3.6. donosi odluke i daje preporuke za poboljšanje zaštite deteta.</p>
<p>4. Këshilli takohet së paku dy (2) herë në vit.</p>	<p>4. The Council shall meet at least two (2) times a year.</p>	<p>4. Savet se sastaje najmanje dva (2) puta godišnje.</p>
<p>5. Ministritë ofrojnë propozime, këshilla, sugjerime dhe rekomandime për Këshillin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës në</p>	<p>5. Ministries provide proposals, suggestions and advice to the Council and the Government of the Republic of Kosovo</p>	<p>5. Ministarstva, Savetu i Vladi Republike Kosova, daju predloge, sugestije i savete o razvoju politika o unapređivanju zaštite</p>

<p>lidhje me zhvillimin e politikave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijës.</p> <p>6. Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, shërben si Sekretariat i Këshillit, për të zhvilluar dhe përkrahur aktivitetet e nevojshme të tij.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Përbërja e Këshillit Ndërministror për Mbrojtjen e Fëmijës</p> <p>1. Këshilli udhëhiqet nga kryeministri dhe përfaqësohet nga ministritë në nivel ministrash.</p> <p>2. Këshilli përbehet së paku nga ministrat e ministrive si në vijim: Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arsimit, Shëndetësisë, Drejtësisë, Punëve të Brendshme, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Administrimit të Pushteti Lokal.</p> <p>3. Në takimet e Këshillit sipas agjendës përkatëse ftohen përfaqësues të institucioneve të pavarura, organizatave të shoqërisë civile, udhëheqës të drejtorive përkatëse, të nivelit qendror dhe lokal, si dhe ekspertë dhe përfaqësues të</p>	<p>regarding the development of policies relating to the protection of the child.</p> <p>6. The Office of Good Governance within the Office of the Prime Minister, serves as a Secretariat of the Council for development and support necessary activities.</p> <p style="text-align: center;">Article 13 Composition of the Inter-Ministerial Council for Child Protection</p> <p>1. The Council is headed by the Prime Minister and represented by ministers at ministerial level.</p> <p>2. The Council shall consist of at least by the ministers of the following ministries: Labour and Social Welfare, Education, Health, Justice and Internal Affairs, Culture, Youth and Sports, Local Government Administration.</p> <p>3. In the meetings of the Council, according to relevant agenda, the following are invited: representatives of independent institutions, civil society organisations, heads of the respective directorates, central and local level, as well as experts and</p>	<p>deteta.</p> <p>6. Kancelarija dobrog upravljanja u okviru Ureda Premijera služi kao Sekretarijat saveta za odvijanje i podršku njegovih potrebnih aktivnosti.</p> <p style="text-align: center;">Član 13 Sastav Međuministarskog saveta za zaštitu prava deteta</p> <p>1. Savet predsedava Premijer, i zastupa se od ministara na nivou ministarstava.</p> <p>2. U sastavu Saveta moraju najmanje biti ministri sledećih ministarstava: Ministarstva rada i socijalne zaštite, Ministarstva obrazovanja, nauke i tehnologije, Ministarstva zdravstva, Ministarstva pravde, Ministarstva unutrašnjih poslova, Ministarstva kulture, omladine i sporta, i ministarstva administracije lokalne samouprave.</p> <p>3. Na sastancima saveta, prema dnevnom redu, pozivaju se i predstavnici nezavisnih agencija, organizacija Civilnog društva, rukovodioci odgovarajućih direkcija centralnog i lokalnog nivoa, te eksperti i predstavnici institucija i druga lica koji su</p>
---	---	--

<p>institucioneve dhe personave të tjerë, që kanë përgjegjësi në fushën e mbrojtjes së fëmijës.</p> <p>4. Obligohen të gjitha institucionet që të bashkëpunojnë dhe të zbatojnë rekomandimet e Këshillit si dhe të ofrojnë të dhënat e kërkuara nga Zyra për Qeverisje të Mirë në emër të Këshillit.</p> <p>5. Qeveria, sipas propozimit të Zyrës për Qeverisje të Mirë, me akt nënligjor përcakton fushëveprimin, përbërjen, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyrën e punës së Këshillit.</p>	<p>representatives of other institutions and persons that have responsibilities in the field of the protection of child protection.</p> <p>4. All institutions are obliged to cooperate and to implement the recommendations of the Council and to provide information required by the Office of Good Governance, on behalf of the Board.</p> <p>5. The Government, upon the proposal of the Office for Good Governance, with a sub-legal act shall determine the scope, composition, duties and responsibilities and manner of work of the Council.</p>	<p>odgovorni za oblast zaštite prava deteta.</p> <p>4. Sve institucije dužne su saradivati sa Savetom i primeniti njegove preporuke, te pružati podatke koje u ime Saveta traži Kancelarija dobrog upravljanja.</p> <p>5. Na predlog Kancelarije dobrog upravljanja, Vlada posebnim podzakonskim aktom, reguliše delokrug, sastav, zadatke i način rada Saveta.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 Roli i Zyrës për Qeverisje të Mirë</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Role of the Office for Good Governance</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Odgovornosti Kancelarije dobrog upravljanja</p>
<p>1. Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, për zbatimin e këtij Ligji, është përgjegjëse që të:</p> <p>1.1. mbështet Këshillin për koordinimin e institucioneve dhe mekanizmave që merren me mbrojtjen e fëmijës;</p> <p>1.2. ofron rekomandime për Këshillin dhe Qeverinë, në çështjet për mbrojtjen</p>	<p>1. The Office of Good Governance within the Office of the Prime Minister for implementation of this Law, is responsible to:</p> <p>1.1. support Council for coordination of institutions and mechanisms that deal with child protection;</p> <p>1.2. provide recommendations to the Council and the Government on issues</p>	<p>1. Kancelarija dobrog upravljanja u okviru Ureda premijera, za sprovođenju ovog zakona, dužna je:</p> <p>1.1. koordinirati sve institucije i mehanizme koji se bave zaštitom deteta;</p> <p>1.2. pružiti savete Savetu i Vladi Republike Kosova o pitanjima zaštite</p>

<p>e fëmijës;</p> <p>1.3. harton politika, në fushën e mbrojtjes së fëmijës si dhe mbështet institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal si dhe organizata të tjera që ofrojnë mbrojtje për fëmijët, në pajtim me legjislacionin në fuqi, në procesin e hartimit dhe zbatimit të politikave në fushën e mbrojtjes së fëmijës.</p> <p>1.4. jep mendime, në bashkëpunim me Zyrën Ligjore të Zyrës së Kryeministrit, për projekt-legjislacionin e përgatitur nga Qeveria, në pajtim me standardet e të drejtave të fëmijës në fuqi;</p> <p>1.5. siguron dhe merr masa në ngritjen e kapaciteteve në fushën e mbrojtjes së fëmijës, të të gjitha strukturave institucionale, që kanë detyrë dhe përgjegjësi mbrojtjen e fëmijës, në nivel lokal dhe qendror;</p> <p>1.6. mbledh të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera dhe i publikon ato;</p> <p>1.7. bashkëpunon me trupa përkatëse qeveritare të shteteve të tjera, si dhe me organizata ndërkombëtare, në çështjet për mbrojtjen e fëmijës;</p>	<p>related to child protection;</p> <p>1.3. draft policies in the field of child protection and supports the responsible institutions at the central and local level and other organisations that provide protection for children, in accordance with the legislation in force in the process of drafting and implementation of policies in the field of the child protection.</p> <p>1.4. provide opinions, in cooperation with the Legal Office of the Prime Minister, for draft legislation prepared by the Government in accordance with the standards of applicable children rights;</p> <p>1.5. provide and take measures in capacity building in the field of child protection of all institutional structures that have the duty and responsibility of child protection in central and local level;</p> <p>1.6. collects statistical and other data and publishes them;</p> <p>1.7. cooperate with relevant governmental bodies of other states, as well as with international organisations in regards to child protection;</p>	<p>prava deteta;</p> <p>1.3. izraditi politike, strategije i planove opšteg delovanja na pitanjima zaštite prava deteta, te saradivati i podržati ministarstva i druge institucije na izradi i primeni akcionih planova za zaštitu deteta kao i inicijativa za promociju zaštite deteta;</p> <p>1.4. u saradnji sa Pravnom kancelarijom Ureda premijera daje mišljenja o Nacrtima zakona pripremljenih od vlade, u skladu sa važećim standardima o pravima deteta;</p> <p>1.5. obezbeđuje i preduzima mere povećanja kapaciteta u oblasti zaštite deteta svih institucionalnih struktura kojima je obaveza i odgovornost zaštita prava deteta na lokalnom i centralnom nivou;</p> <p>1.6. prikuplja statističke i druge podatke i objavljuje ih;</p> <p>1.7. saraduje srodnim vladinim telima drugih država i međunarodnim organizacijama, po pitanju zaštite deteta;</p>
--	--	---

